

Dikush mund të pyesë: Përse biseda rreth xhenetit bëhet pikërisht në këtë muaj?

Për faktin se në qiell, kur vjen muaji i Ramazanit, ndodh një ngjarje e madhe, e ajo është hapja e dyerve të xhenetit. I Dërguari, lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, thotë: “Kur vjen muaji i Ramazanit, hapen dyert e xhenetit, mbyllen dyert e xhehenemit dhe prangosen djajtë.” Shënon Buhariu dhe Muslimi. Këto fakte argumentojnë për madhështinë, vlerën dhe pozitën e lartë që ka ky muaj tek Allahu i Lartësuar. Nga kjo pikënisje dëshiroj t'ia kujtoj xhenetin atij që e arrin përjetimin e këtij muaji, t'ia kujtoj begatinë e tij si dhe veprat që e ndihmojnë dhe ia lehtësojnë muslimanit hyrjen në të.

Imam Neveviu, Allahu e mëshiroftë, duke transmetuar fjalët e Kadi Ijadit thotë: “Është e mundshme që hapja e dyerve të xhenetit nënkupton se Allahu në këtë muaj i bekon robërit e Tij me disa adhurime të cilat nuk bëhen në muajt e tjerë, si agjërimi, falja e namazit të teravive e të tjera. E, këto pa dyshim se konsiderohen shkaqe për hyrjen në xhenet.

Këtë tematikë, me ndihmën e Allahut, do ta trajtoj nga dy kënd-vështrime:

1. Karakteristikat motivuese për hyrjen në xhenet. 2. Veprat të cilat janë përcaktuar nga ana e fesë si ndihmë dhe lehtësim për hyrjen e muslimanit në xhenet.

Pa dyshim se Ramazani është rast i mirë për vepra të mira, ngase zemra është e gatshme t'u nënshtrohet urdhrave të Allahut, ashtu siç është edhe shpërblimi i shumëfishuar. Në hadithin e lartpërmendur aludohet për këtë domethënie, pra për shpërblimin dhe për faljen e madhe.

O ti kërkues i së mirës, dyert e xhenetit janë të hapura! O ti kërkues i së keqes, dyert e xhehenemit janë të mbyllura!

PIKËNISJET PËR NË XHENET

1. Allahu e obligoi të Dërguarin e Tij, Muhamedin, lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, që t'i përgëzojë me xhenet ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira. Allahu i Lartësuar thotë:

“Ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, gëzoji me kopshte të xhenetit, nëpër të cilat rrjedhin lumenj.” (Bekare, 25)

2. Shokët e të Dërguarit, Allahu qoftë i kënaqur me ta, gjithmonë e pyesnin atë për veprat të cilat janë shkak për t'u futur në xhenet. Kjo pa dyshim se është argument për kujdesin dhe interesimin e tyre për xhenetin si dhe për veprat të cilat i afrojnë pranë tij.

3.Hyrja në xhenet konsiderohet fitorja reale.Allahu i Lartësuar thotë: “Kushdo që shpëton nga zjarri i xhehenemit dhe hyn në xhenet, ai ka fituar (gjithçka që mund të dëshirohet).” (Ali Imran,185)

4. Respektimi dhe bindja ndaj Allahut të Lartësuar dhe ndaj të Dërguarit të Tij janë prej shkaqeve më të rëndësishme për hyrjen në xhenet.Allahu thotë: “Atë që i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij,Ai e shpie në kopshte,nëpër

të cilët rrjedhin lumenj dhe ku do të qëndrojnë përherë.Kjo është fitorja e madhe.” (Nisa,13)

5. Vendi sa zë një kamxhik në xhenet është më i mirë sesa kjo botë dhe çfarë ka në të.

6. Begatia e xhenetit e tejkalon imagjinatën e as nuk mund të përshkruhet, siç thotë Allahu i Lartësuar në hadithin kudsij: “Për robërit e Mi të mirë kam përgatitur atë që syri nuk e ka parë asnjëherë, as veshi nuk ka dëgjuar për të e as që i ka shkuar ndër mend kurrë.” Shënon Buhariu.

O Allah,ne të kërkojmë xhenetin!

Prandaj, eja të flasim së bashku për xhenetin dhe begatitë e tij në këtë muaj.Eja të njihemi me punët të cilat na ndihmojnë të hyjmë në xhenet,të jetojmë në të me shpirtrat tanë,edhe pse jemi ende në këtë botë.Le të kemi mall për të në zemrat tona para se të na fusë Allahu i Lartësuar në të,inshallah.Allahu Fuqiplotë thotë: “Dhe një zë do t'i thërrasë: “Ky është xheneti që ju e keni merituar për atë që keni punuar.” (A'raf,43)

PESËMBËDHJETË KARAKTERISTIKA MOTIVUESE PËR TË HYRË NË XHENET

1.ALLAHU NA KA PREMTUAR SE DO TË NA FUSË NË XHENET. Ai thotë: “Në të vërtetë, Allahu ka blerë nga besimtarët jetën dhe pasurinë e tyre, në këmbim të xhenetit.” (Tevbe,111)

2. QËNDRIM I PËRHERSHËM NË XHENET.Allahu i Lartësuar thotë:“Me të vërtetë,ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira, do të kenë për banesa kopshtet e Firdeusit, ku do të qëndrojnë përherë, duke mos dëshiruar asnjë ndryshim.”

(Kehf,107-108)

3. TOKA EXHENETIT Ë SHITË PREJ MISKUT. IDërguari, lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, thotë: “Hyra në xhenet... toka e xhenetit ishte prej miskut.” Shënon Buhariu dhe Muslimi.

4. LUMENJTË E TIJ JANË TË SHUMËLLOJSHËM. Allahu i Lartësuar thotë: “Ja përshkrimi i xhenetit, që u premtohet të përkushtuarve (ndaj Allahut): një vend ku ka lumenj me ujë të pandotur, lumenj qumështi me shije të pandryshuar, lumenj vere me shije të këndshme për ata që e pinë dhe lumenj prej mjalti të kulluar. Ata do të kenë aty lloj-lloj frutash.”

(Muhamed,15)

5. BURIMET E TIJ JANË TË SHUMTA. Allahu i Lartësuar thotë: “Pa dyshim, ata që i frikësohen Allahut do të jenë në kopshte dhe burime.”

(Dharijat,15)

6. PALLATET E TIJ JANË TË MREKULLUESHME. Allahu i Lartësuar thotë: “...si dhe pallate të mrekullueshme në xhenetin e Adnit.” (Tevbe,72)

7. NUMRI I DYERVE TË TIJ ËSHTË TETË DHE ATO JANË TË GJERA. Allahu i Lartësuar thotë: “...në kopshtet e Adnit, dyert e të cilit janë të hapura për ta.” (Sad,50)

8. PEMËT ETIJ JANË MË TË ËMBLAT dhe më të këndshmet. Allahu i Lartësuar thotë: “Aty do të prehen e do të kënaqen me pemë dhe pije të llojlojshme.” (Sad, 51)
Gjithashtu thotë: “Punëdrejtët do të jenë mes hijesh e burimesh si dhe frutash nga ato që dëshirojnë.” (Murselat,41-42)

9. USHQIMI I TIJ ËSHTË I ZGJEDHUR. Allahu i Lartësuar thotë: “Aty do të ketë çfarë t'ju dojë shpirti dhe gjithçka që ta kënaq syrin dhe atje do të qëndroni përgjithmonë.” (Zuhruf,71)

10. VERËRAT E TIJ JANË TË MIRA, të këndshme, të shijshme; ata që e pinë, as nuk do të trullosen dhe as nuk do të dehen. Allahu i Lartësuar thotë: “Aty do t'u shërbehet një gotë e mbushur nga një burim i rrjedhshëm, (me pije) të bardhë e të shijshme për ata që do ta pinë. Prej saj as nuk do të trullosen dhe as nuk do të dehen.” (Safat,45)

11. RROBAT E TIJ JANË TË SHTRËNJTA. Allahu i Lartësuar thotë: "...dhe do të vishen me rroba të gjelbra prej mëndafshi të hollë dhe armaçi, duke ndenjur të mbështetur në shtretër të lartë. Sa shpërblim i mrekullueshëm dhe sa vendbanim I bukur!" (Kehf, 31)

12. SHTRËTËRIT E TIJ JANË TË SHTRIRË. Allahu i Lartësuar thotë: "Ata (banorët e devotshëm që do të hyjnë në këto kopshte) do të jenë të mbështetur në shtroje, anash me armaç mëndafshi." (Rahman, 54)

13. BASHKËSHORTET E BANORËVETË XHENETIT (hyritë).Allahu i Lartësuar thotë:"Po,kështu do të jetë dhe Ne do t'i martojmë ata me hyri sybukura."

(Duhan,54)

14. KËNAQËSIA E MADHE, SHIKIMI I ALLAHUT. Allahu i Lartësuar thotë: "Atë ditë disa fytyra do të shkëlqejnë dhe Zotin e tyre do të shohin."

(Kijame,22-23)

15. ËSHTË I PËRGATITUR PËR TË DEVOTSHMIT. Allahu i Lartësuar thotë: "Nxitoni drejt faljes së gjynaheve nga Zoti juaj dhe xhenetit,hapësira e të cilit është sa qiejt e toka dhe që është përgatitur për të devotshmit." (Ali Imran,133)

Çfarëkarakteristikash,tëcilatzemraveushtojnëgëzim,kënaqësidhe mall!

SHKAQE QË NDIHMOJNË PËR TË HYRË NË XHENET

Ekzistojnë vepra të mira të cilat, me vullnetin e Allahut, të ndihmojnë për të hyrë në xhenet. Mirëpo, para se të fillojmë t'i përmendim disa prej këtyre veprave, është e domosdoshme të dihet se në xhenet nuk do të hyjë kush tjetër përveç besimtarit. Prandaj, imani (besimi) është kusht thelbësor për hyrjen në të. Allahu i Lartësuar thotë: "Kurse ata që besojnë e bëjnë vepra të mira, do të jenë banorë të xhenetit, ku do të qëndrojnë përgjithmonë." (Bekare,82) Ndërsa disa nga veprat ndihmuese për hyrjen në xhenet janë:

1. DEVOTSHMËRIA, e cila pa dyshim konsiderohet si dobi shpresëdhënëse nga agjërimi i Ramazanit. Allahu i Lartësuar thotë: "Vërtet të devotshmit do të jenë në kopshtet e xhenetit pranë burimeve." (Hixhr, 45). Gjithashtu, Ai thotë: "Ky është

xheneti që Ne ua japim në trashëgim robërve Tanë të përkushtuar.” (Merjem, 63). Kurse devotshmëria është që të vësh në mes teje dhe Allahut një mburojë ndaj mëkateve, duke respektuar urdhrat e Tij dhe duke u larguar nga ndalesat e Tij.

2. QËNDRUESHMËRIA DHE VENDOSMËRIA haptazi dhe fshehurazi deri në vdekje. Allahu i Lartësuar thotë: “Me të vërtetë, atyre që thonë: “Zoti ynë është Allahu”, e pastaj vazhdojnë të vendosur në rrugën e drejtë, do t'u zbresin engjëjt (para vdekjes) e do t'u thonë: “Mos u frikësoni dhe mos u pikëlloni! Dhe gëzojuni xhenetit që ju është premtuar.” (Fusilet, 30). Ndërsa në hadith qëndron: “Thuaj: “Besova në Allahun” e pastaj përqendrohu në të (në atë që aludon kjo fjalë).” Shënon Muslimi. Qëndrueshmëria dhe përqendrimi do të thotë

vazhdimësi në respektimin e Allahut deri në vdekje.

3. MARRJA E TË DËRGUARIT SI SHEMBULL dhe model jete. Allahu i Lartësuar thotë: “Kush i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, do të shkojë në xhenete, nëpër të cilat rrjedhin lumenj, kurse ai që shmanget, do të ndëshkohet me dënim të dhembshëm.” (Fet'h, 17). Ndërsa i Dërguari i Allahut, lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, thotë: “I gjithë umeti im do të hyjë në xhenet, përveç atij që refuzon.” Thanë: “Kush është ai që refuzon?” Tha: “Kush më bindet mua, do të hyjë në xhenet, ndërsa kush më kundërshton, ka refuzuar.” Shënon Buhariu.

Marrja shembull e të Dërguarit të Allahut nënkupton ndër-timin e sjelljes së muslimanit si dhe të të gjitha akteve të tij, qofshin ato fjalë ose vepra, në pajtim me atë që ka sjellë i Dërguari nga ana e Zotit të tij, duke e pasuar atë si dhe duke i pranuar prej tij këto veprime për shkak se ai konsiderohet i Dërguar i Allahut. Allahu i Lartësuar thotë: “Në të Dërguarin e Allahut ka një shembull të mrekullueshëm.” (Ahzab, 21)

4. PENDIMI I SINQERTË TEK ALLAHU. Allahu i Lartësuar thotë: “...përveç atyre që pendohen, që besojnë dhe bëjnë punë të mirë. Këta do të hyjnë në xhenet dhe nuk do t'u bëhet kurrfarë padrejtësie.” (Merjem, 60). Kurse me pendim nënkuptohet largimi nga të gjitha mëkatet e gabimet, pendim për çdo mëkat të kaluar si dhe vendosmëri për të mos iu kthyer atij mëkati në të ardhmen.

5. KËRKIMI I DITURISË PËR HIR TË ALLAHUT si dhe për hir të kënaqësisë së Tij. I Dërguari, lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, thotë: “...kush trason rrugën për të kërkuar dituri, atij Allahu do t'ia lehtësojë rrugën për në xhenet.” Shënon Muslimi. Kërkimi i diturisë në muajin e Ramazanit mund të manifestohet përmes shumë formash:

-të mësuarit e dispozitave të agjërimit;

njohja me gjendjen e të parëve tanë në Ramazan; -komentimi i ajeteve të agjërimit sidhekuptimi i idomethënievetëtyre; njohja me ngjarjet historike që kanë ndodhur në këtë muaj.

Shënon Muslimi. Kurse me moral të mirë nënkuptohet stolisja me mirësi dhe largimi nga shthurja.

6. MIRËSJELLJA ME NJERËZIT. I Dërguari, lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, ka thënë: “Ajo që më së shumti i fut njerëzit në xhenet është devotshmëria dhe sjellja e mirë...”. “Moral i tij (Muhamedit alejhi selam) ishte Kurani.”

7. SHQIPTIMI I DËSHMISË PAS ABDESTIT. I Dërguari, lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, thotë: “Kush merr abdest në mënyrë të përpiktë e pastaj thotë: “Dëshmoj se nuk ka hyjni tjetër pos Allahut, të Vetmit, i Cili nuk ka shok, dhe dëshmoj se Muhamedi është rob dhe i Dërguar i Tij”, i hapen tetë dyert e xhenetit dhe hyn nga cila derë të dëshirojë.” Shënon Muslimi.

8. SHKUARJA NË XHAMI për kryerjen e pesë namazeve apo të adhurimeve të tjera. I Dërguari, lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, thotë: “Kush shkon në xhami apo kthehet nga xhamia, Allahu ia përgatit një vend në xhenet sa herë që shkon apo vjen.” Shënon Muslimi.

9. VIZITA E TË SËMURIT apo e vëllait në fe për hir të Allahut. I Dërguari, lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, thotë: “Kush viziton një të sëmure apo ndonjë vëlla të tij për hir të Allahut, thërret një thirrës: “Të lumtë dhe lum ti për ecjen tënde! Ke përgatitur në xhenet një shtëpi.” Shënon Tirmidhiu.

10. PËRSËRITJA E EZANIT ME SINQERITET për hir të Allahut. I Dërguari, lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, thotë: “Nëse muezini thotë: “Allahu Ekber, Allahu Ekber”, e dikush nga ju thotë: “Allahu Ekber, Allahu Ekber”... (pastaj ka përmendur ezanin)... pastaj (muezini) thotë: “Hajje ales-salah”, e dikush nga ju thotë: “La haule ue la kuuete il-la bil-lah”, pastaj (muezini) thotë: “Hajje alel felah”, e dikush nga ju thotë: “La haule ue la kuuete il-la bil-lah”... e pastaj (muezini) thotë: “La ilahe il-la Allah”, e përcjellësi thotë: “La ilahe il-la Allah” me zemër të sinqertë, dotëhyjënë xhenet.” Shënon Muslimi.

11. FALJA E DY REKATEVE PAS ABDESTIT. Ukbete b. Amiri, Allahu qoftë i kënaqur me të, transmeton se i Dërguari, lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, ka thënë: “Kush merr abdest në mënyrë të përpiktë dhe pastaj i fal dy rekate i përqendruar me zemrën dhe fytyrën e tij (gjatë namazit), atij i obligohet xheneti.” Shënon Muslimi.

12. KRYERJA E NAFILEVE TË SHUMTA. Rebia b. Es'habi,Allahu qoftë i kënaqur me të,rrëfen duke thënë:"I shërbeja dhe i sillja ujë të Dërguarit,kurse ai më tha: "Më kërkko". Thashë: "Të kërktoj shoqërimin tënd në xhenet!" Ai tha: "Më ndihmo duke bërë shumë sexhde." Shënon Muslimi.

Shënon Ibn Maxheh.

14. PËRHAPJA E SELAMIT, USHQIMI ITËTJERËVE SI DHE FALJA E NAMAZIT NATËN.I Dërguari,lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, thotë: "O ju njerëz, përhapeni selamin (përsëndetjen),jepni ushqim,faluni natën kur njerëzit janë në gjumë, do të hyni në xhenet me selam (paqe)."

13. KUJDESI NDAJ JETIMIT. I Dërguari, lavdërimi dhe paqja eAllahut qoftë mbi të,ka thënë: "Unë dhe kujdestari i jetimit jemi në xhenet kështu", dhe bëri me shenjë me gishtin tregues dhe gishtin e mesëm." Buhariu.

15. LEXIMI I AJETUL KURSISË pas çdo namazi farz (obligativ).I Dërguari,lavdërimi dhe paqja eAllahut qoftë mbi të, ka thënë: "Kush lexon ajetin kursij pas çdo namazi të detyruar,e pengon atë nga hyrja në xhenet veçse vdekja." Shënon Nesaiu.

16. ZOTËRIA I ISTIGFARIT (lutja më e mirë e kërkimit të faljes). "O Allahu im!Vetëm Ti je Zoti im, nuk ka zot tjetër përveç Teje. Më krijove dhe unë jam robiYt..." Shënon Buhariu nga Shedad b. Evisi e pastaj ka thënë: "Kush e thotë ditën duke qenë i bindur në të dhe vdes atë ditë ende pa u ngrysur,ai do të jetë prej banorëve të xhenetit. Ndërsa kush e thotë natën dhe është i bindur në të si dhe vdes pa u gdhirë, ai po ashtu do të jetë prej banorëve të xhenetit."

17. KUJDESI PËR ABDESTIN. Që nënkupton vazhdimësinë e pastrimit pas çdo ndyrësire. I Dërguari, lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, i ka thënë Bilalit: "O Bilal,më trego cila punë që ke bërë në Islam të jep më shumë shpresë?Vërtet unë e kam dëgjuar zhurmën e nallaneve të tua para meje në xhenet."Bilali u përgjigj:"Puna që kam bërë dhe prej së cilës shpresoj fitimin më të madh është ajo që asnjëherë ditën apo natën,kur kam marrë abdest,me atë abdest të mos kem falur atë që më është urdhëruar të fal." Buhariu dhe Muslimi.

18. LARGIMI I PENGESAVE NGA RRUGA e muslimanëve. I Dërguari, lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, ka thënë: “Kam parë një burrë në xhenet që ka hyrë në të për shkak të një peme të cilën e ka hequr nga rruga, pemë e cila i pengonte njerëzit.” Shënon Muslimi.

19. FJALA E MIRË. I Dërguari, lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, ka thënë: “Në xhenet ka një dhomë, pjesa e jashtme e së cilës shihet nga brenda, kurse brendësia e saj shihet nga jashtë.” Ebu Malik El Esh'arij tha: “Për kë është ajo, o i Dërguar i Allahut?” Ai tha: “Për atë që flet mirë, që i ushqen të varfrit si dhe për atë që falet kur njerëzit flenë.” Shënon Taberani dhe Hakimi.

-agjërimi; -përcjellja e xhenazes; -vizita etë sëmurit; -të ushqyerit etë varfrit.

Argument lidhur me këtë kemi hadithin të cilin e transmeton Ebu Hurejra, Allahu qoftë i kënaqur me të, ku i Dërguari, lav-dërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, ka thënë: Kush prej jush u zgjua sot agjërueshëm? Ebu Bekri tha: Unë. Kush prej jush përcolli sot ndonjë xhenaze? Ebu Bekri tha: Unë. Kush ushqeui sot ndonjë të varfër? Ebu Bekri tha: Unë. Kush vizitoi sot ndonjë të sëmurë? Ebu Bekri tha: Unë. Atëherë i Dërguari tha: -Nuk bashkohen te ndonjëri këto cilësi e të mos hyjë në xhenet. Shënon Muslimi.

20. NËSENJËSËRËVEPRASHTË MIRA bashkohen te muslimani gjatë ditës, ai do të hyjë në xhenet:

Këto ishin njëzet forma të cilat e ndihmojnë muslimanin që ta fitojë xhenetin me dëshirën e Allahut. Muslimani gjatë këtij muaji ka mundësi t'i aplikojë këto forma në mënyrë që të jenë ndihmë për të. Kurse në xhenetin në këtë muaj e kemi përmendur vetëm për shkak të dëshirës së madhe të zemrave tona për të. Rikujtimi i begatëve të tij pa dyshim se është një motivim për të punuar vepra të mira, veçanërisht kur ne e përjetojmë këtë muaj të vlefshëm.

I Dërguari i Allahut, lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë mbi të, ka thënë: “Kur vjen muaji i Ramazanit, hapen dyert e xhenetit.” Shënon Buhariu

RAMAZANI DHE RREGULLAT E TIJ

Lavdërimi i takon vetëm Allahut. Bekimi dhe paqja qofshin mbi të dërguarin e Tij. Në këtë fletëpalosje do të keni mundësinë të lexoni rregullat dhe normat që kanë të bëjnë me muajin Ramazan, rregulla të cilat janë shkëputur nga librat e hadithit dhe

thëniet e dijetarëve,në mënyrë të përmbledhur.Lus Allahun e Lartësuar për sinqeritet në thënie dhe vepra!

1. Agjërimi i muajit Ramazan është një nga shtyllat e Islamit. Për këtë kemi të njejtin mendim (ixhma) nga të gjithë dijetarët. Kjo është e vërtetuar me citate nga Kurani dhe Suneti. Allahu i Lartësuar thotë: "O ju të cilët besuat! Agjërimi ju është bërë obligim, sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm."

Bekare;183. Profeti (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) thotë: "Islami është i ndërtuar mbi pesë shtylla...(ndër këto pesë) është edhe agjërimi i muajit Ramazan"Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

2. Obligohemi me agjërimin e Ramazanit, kur të shihet hëna e re e muajit Ramazan. Kjo ndodh në natën e tridhjetë të muajit shaban. E nëse nuk shihet hëna e re (në këtë natë), atëherë fillojmë agjërimin, pasi muaji shaban t'i ketë përmbushur tridhjetë ditë.

Hëna e re duket pas perëndimit të diellit në fundin e ditës së njëzet e nëntë të muajit shaban. Nëse ajo duket para perëndimit,atëherë ajo nuk merret parasysh.

3. Nuk lejohet agjërimi i ditës së dyshimtë, e cila është dita e tridhjetë e muajit shaban. Nëse nuk kemi mundësi ta shohim hënën, për shkak të reve, duhet të plotësojmë tridhjetë ditë të muajit shaban. Për këtë çështje

ekzistojnë disa hadithe, disa prej tyre po i përmendim më poshtë:

c) "Nëse koha është me re (dhe nuk mundeni ta shihni hënën), atëherë plotësoni tridhjetë ditët e shabanit." Transmeton Buhariu dhe Muslimi.

a) "Mos i paraprini Ramazanit me agjërim një ditë apo dy ditë."

b) Thënia e Amarit (Allahu qoftë i kënaqur me të!):"Kush agjëron ditën të cilën dyshon (a është Ramazan apo jo) vetëm se e ka kundërshtuar Ebu Kasimin

(Muhamedin, salallahu alejhi ue selem)." (Hadithin e transmeton Tirmidhiu, Ebu Daudi, Nesaiu, Ibën Maxhe dhe e vërteton Ibën Huzejme, ndërsa Buhariu e përmend në koleksionin e tij si mualek (pa zinxhirin e transmetuesve).

4. Përkufizimi i agjërimit është: Ta ndalosh veten nga ushqimi, pija dhe mardhëniet seksuale nga fillimi i lindjes së diellit deri në perëndim, me qëllim të adhurimit të Allahut të Lartësuar.

5. Agjërimi është obligim për çdo musliman, i cili arrin moshën e pjekurisë, është mendërisht i shëndoshë, nuk është udhëtarë, është i aftë për të agjëruar dhe është i liruar nga gjërat që e ndalojnë agjërimin.

6. Fëmija, nëse arrin moshën e pjekurisë gjatë një prej ditëve të Ramazanit, obligohet të agjërojë pjesën e mbetur të ditës dhe nuk obligohet ta kompensojë atë ditë. Para se të arrijë pjekurinë preferohet ta mësojmë atë me agjërim, ashtu siç vepronin sahabët me fëmijët e tyre, gjë e cila është transmetuar në hadithe.

7. Nëse të sëmurit agjërimi nuk i bën mirë, atij nuk i lejohet të agjërojë. Nëse agjërimi për të është i vështirë, atëherë preferohet prishja e agjërimit. Nëse për të agjërimi nuk është i vështirë, atëherë ai obligohet të agjërojë.

8. Nëse i sëmuri shërohet gjatë ditës dhe i largohet arsyeja e prishjes së agjërimit, atij i lejohet ta vazhdojë ditën pa agjëruar.

9. I sëmuri i cili nuk mundet të agjërojë dhe nuk shpresohet në shërimin e tij, obligohet të mos agjërojë dhe për çdo ditë (të Ramazanit) të ushqejë një të varfër si kompensim. Ai e bën këtë vetëm pasi të përfundojë dita. Të njejtën dispozitë e kanë edhe ata që janë të paafte në agjërim dhe nuk pritet se do të aftësohen ndonjëherë, si pleqëria e thellë.

10. Ai i cili nuk ka mendje, nuk obligohet të agjërojë e as të kompensojë agjërimin, për arsye se është i liruar nga të gjitha dispozitat.

11. Gruaja e cila është me menstruacione (hajz) dhe lehoni (nifas) nuk i lejohet të agjërojë, për shkak të gjendjes së tyre, ndërkohë që për ta kërkohet t'i kompensojnë me agjërim ditët që nuk i kanë agjëruar (t'i bëjnë kaza). Nëse fillon të rrjedh gjaku (i menstruacioneve) gjatë ditës së Ramazanit, agjërimi i saj prishet. Nëse gruaja

pastrohet nga menstruacionet apo lehonja gjatë ditës së Ramazanit, nuk obligohet të agjërojë pjesën tjetër të ditës, sipas mendimit më të saktë të dijetarëve,(porsiq përmendëm e agjëron atë ditëkaza).

12. Udhëtarit i lejohet prishja e agjërimin, për shkak të udhëtimit edhe nëse nuk has në vështirësi. Nëse has në vështirësi, atëherë preferohet prishja e agjërimin. Më së miri për të është të veprojë atë që është më e përshtatshme për të. Nëse, edhe sikur të agjërojë apo mos të agjërojë është njëjtë për të, atëherë më së miri për të është të agjërojë, për shkak se ai me këtë e liron veten duke e kryer agjërimin dhe më e lehtë për të është të agjërojë me njerëzit. Ky është edhe mendimi i shumicës së dijetarëve.

13. Nëse udhëtari përfundon udhëtimin duke arritur në shtëpi, atij i lejohet të vazhdojë ditën pa agjëruar, sipas mendimit më të saktë, kurse nëse arrin në shtëpi duke qenë agjërueshëm, nuk i lejohet ta prish atë.

14. Nëse njeriu del nga shtëpia si udhëtar duke agjëruar, atij i lejohet ta prish atë kur të largohet nga vendbanimet që gjenden në qytetin apo fshatin e tij.

15. Gruaja shtatzënë apo ajo që e ka fëmijën në gj, nëse frikësohet për fëmijën e saj, për vete, apo për fëmijën dhe veten e saj, i lejohet prishja e agjërimin dhe u kërkohet ta gjërojnë më vonë (kaza). Sipas mendimit më të saktë të dijetarëve, në këtë rast ato nuk obligohen të ushqejnë për çdo ditë një të varfër.

16. Bërja e nijetit (me zemër) gjatë natës (para lindjes së diellit) për agjërimin që është farz, është obligim.

17. Nëse vërtetohet me dëshmi të saktë hyrja e muajit gjatë ditës, atëherë obligohemi të vazhdojmë atë pjesë të mbetur me agjërim dhe ta kompensojmë atë ditë me agjërim (kaza). Ky është mendimi i shumicës së dijetarëve.

18. Nëse nuk kemi ndërprerje gjatë këtij muaji, mjafton të bëjmë një herë nijetin për agjërimin e të gjithë muajit Ramazan. Kjo është sipas mendimit më të saktë, kjo është njëkohësisht edhe zgjedhja e shejhut të Islamit, Ibën Tejmijes dhe thënia e imam Malikut.

19. Nëse agjëruesi ha, pi, apo bën marrëdhënie seksuale në harresë, atij nuk i prishet agjërimi.

20. Atij të cilit i lejohet prishja e agjërit për ndonjë shkak të arsyetuar, atij i lejohet ta vazhdojë ditën pa agjërim dhe nuk kërkohet ta ndalojë veten në pjesën tjetër të ditës.

21. Gjërat që e prishin agjërimin: -Mardhëniet seksuale, nëse ndodhin gjatë ditës së Ramazanit, atëherë për këtë kërkohen këto gjëra:

a) Ajo ditë konsiderohet e prishur dhe obligohet vazhdimi i pjesës tjetër të ditës në agjërim dhe obligohet kazaja për atë ditë. b) Pasi kjo vepër është mëkat, atëherë kërkohet nga personi të bëjë teube (pendim). c) Si shpagim (për mëkatin e bërë) obligohet lirimi i një robi musliman. Nëse për këtë nuk ka mundësi, atëherë obligohet të agjërohet dy muaj rrjesht pa ndërprerje, përveç ndonjë shkakut të arsyetuar shariatikisht (nëse bien ditët e bajrameve, apo për shkak të sëmundjes, udhëtimit etj.). Nëse agjërimi ndërpritet pa arsye, atëherë obligohet të rifillohet agjërimi nga dita e parë, në mënyrë që ai të realizohet pa ndërprerje. Nëse është e pamundur të agjërohet dy muaj rrjesht, atëherë obligohet ushqimi i gjashtëdhjetë të varfërve. Nëse edhe për këtë nuk ka mundësi, atëherë ky obligim bie.

-Ejakulimi (dalja e spermës) me vetëdëshirë, qoftë kjo me puthje, prekje, shikim, apo masturbim. Nëse kjo ndodh në gjumë, atëherë agjërimi nuk prishet, për shkak se ejakulimi ka ndodhur pa dëshirën (vetëdijën) e tij.

22. Ngrënia dhe pirja dhe çfarë nënkuptohet me këtë si: infuzionet ushqyese. Kurse injeksionet joushqyese nuk e prishin agjërimin. Nga gjërat që e prishin agjërimin, gjithashtu, është edhe marrja e gjakut, nëse agjëruesi ka gjakderdhje dhe ka nevojë për gjak. Prandaj, sipas mendimit të saktë të dijetarëve, edhe dializa konsiderohet nga gjërat që e prishin agjërimin.

23. Vjellja (nxjerrja e ushqimit) qëllimisht e prish agjërimin. Nëse kjo ndodh pa dëshirë, atëherë agjërimi nuk priset.

24. Rrjedhja e gjakut të hajzit apo nifasit. Kurdo që femra e sheh gjakun e hajzit apo nifasit e prish agjërimin, pa marrë parasysh e sheh atë në fillim të ditës, në mesditë, apo në fund të ditës, qoftë edhe pak momente para perëndimit.

25. Përdorimi i kuhlit (është një lloj ngjyre për sy), apo ilaçit (me pika) për sy nuk e prish agjërimin, edhe nëse atë e ndiejmë në fyt.

26. Agjërimi nuk priset, nëse përdor pika në vesh apo nëse vendos ilaç mbi plagë, edhe nëse e ndien shijen e ilaçit në fyt.

27. Nuk priset agjërimi nëse përdor barëra në anus apo në organin gjenital (qofshin për temperaturë apo diçka tjetër).

28. Nëse agjëruesi shijon gjellën, duke mos e gëlltitur brenda, apo nëse merr erë parfumi, nuk e prish agjërimin. (Për më gjësisht shih: "Mexhmu'l fetaua" vëll.25,f.242)

29. Nëse agjëruesi përdor misvakun, nuk e prish agjërimin, përkundrazi, përdorimi i tij gjatë gjithë ditës është sunet. Imam Buhariu për përdorimin e misvakut gjatë agjërimit përmend tri lloje argumentesh.

30. Agjëruesit i lejohet të bëjë të gjitha veprat që ia lehtësojnë atij agjërimin, si: mosdalja në diell, larja me ujë të ftohtë etj.

31. Nëse ndodh që agjëruesi e arrin mëngjesin duke qenë i papastër (xhunub),qoftë nga mardhëniet seksuale apo diçka tjetër, ai duhet të vazhdoj agjërimin, edhe pse

nuk është pastruar deri pas lindjes së diellit. Gjithashtu, edhe gruaja që është me menstruacione, nëse i ndalen ato natën, por nuk është pastruar derisa del mëngjesi, ajo e agjëron atë ditë.

32. Kush e prish agjërimin me ushqim apo pije dhe qëllimi i tij është të bëjë marrëdhënie seksuale, për të vlen shpagimi (kefareti). (Shih: "Muxhmu'l Fetava" vëll. 25, f.260-262.)

33. Kush e humb vetëdijen gjatë ditëve të Ramazanit, ai i plotëson ato ditë pasi t'i kthehet vetëdija.

34. Atij që i kanë mbetur pa agjëruar nga ditët e Ramazanit dhe e vonon këtë, afati i fundit i kompensimit të tij është fillimi i muajit Ramazan i vitit të ardhshëm. Kjo nëse nuk ka arsye.

35. Kush e vonon pa arsye agjërimin (kaza) të atyre ditëve që nuk i ka agjëruar, derisa të vijë Ramazani i ardhshëm, nga ai kërkohet të pendohet (për këtë vonesë) dhe të plotësoj këto ditë. Edhe pse transmetohet nga tre sahabë se nga ata kërkohet, krahas plotësimit, edhe të ushqejnë nga një të varfër për secilën ditë, por nga citatat kuranore që flasin për këtë çështje kuptohet se kërkohet vetëm plotësimi. Kjo është edhe zgjedhja e imam Buhariut në koleksionin e tij. (Shih: "Fet`hu bari" vëll. 4, f.188.)

36. Nga agjëruesi kërkohet që përfundimisht të largohet nga fjalët dhe veprat e ndaluara, ashtu siç thotë Profeti (salallahu alejhi ue selem): "Ai i cili nuk i braktis: dëshminë e rreme, të vepruarit me të dhe veset (punët) e këqia, Allahu nuk ka nevojë që ai person të lejë ushqimin dhe pijen." (Buhariu dhe Muslimi)

37. Nuk i lejohet agjëruesit të përpijë ushqimet e mbetura në dhëmbë, por nëse ndodh kjo pa dije, atëherë nuk i priset agjërimi.

38. Sipas mendimit më të saktë të dijetarëve, përcjellja e pështymës (edhe kur është shumë) nuk e prish agjërimin, edhe pse preferohet që ajo (pështyma) të nxirret jashtë, nëse është e mundur.

39. Nëse rrjedh gjak nga dhëmbët apo goja, nuk i lejohet agjëruarit (edhe ai që nuk agjëron) ta çojë atë poshtë në bark, për shkak se ajo konsiderohet e papastër dhe me të prishet agjërimi.

40. I lejohet agjëruarit t'i afrohet gruas së tij, ta puthë, përkëdhel apo ledhatojë atë, ashtu siç transmetohet nga Profeti (salallahu alejhi ue selem), por duhet të kemi kujdes, për shkak se Aishja (gruaja e tij) thotë se ai mundej ta përmbante veten. Prandaj, ai i cili ka mundësi ta përmbaj veten i lejohet kjo, nëse nuk është i sigurtë, atëherë mos t'i afrohet rrezikut. Pas përfundimit të diellit e deri në syfyrr marrdhëniet intime bashkëshortëve janë të lejuara.

41. Nga suneti është që agjëruarit të bëjë iftar me hurma, nëse nuk gjen, atëherë me ujë e nëse edhe ky nuk i gjindet, atëherë me çfarë të ketë mundësi.

42. Preferohet që agjëruarit të bëjë dua (lutje) para iftarit, siç transmetohet nga Ebu Daudi dhe Darekutni, i cili e bën hadithin të mirë. Nga Abdullah ibën Umeri transmetohet se i dërguari i Allahut (Paqja dhe bekimi qofshin mbi të!) ka thënë: "Iku etja e u rigjallëruan damarët. Mbeti shpërblimi tek Allahu, inshallah!". Kjo lutje bëhet njësoj gjatë verës apo dimrit.

43. Kush vdes dhe i ka mbetur pa agjëruar (borxh) nga Ramazani, nëse ai ka patur mundësi t'i plotësojë, por nuk i ka agjëruar sa ishte gjallë, ato ditë i plotëson me agjërim një nga të afërmit e tij (vëllai, babai, gruaja). Ky agjërim nuk është i obliguar për të (ai që ia plotëson agjërimin), për shkak se sipas rregullit të përgjithshëm në Islam, askush nuk merr përsipër mëkatin e tjetërkujt. Nëse i ngarkuari për plotësimin e agjërimit të tij nuk i plotëson këto ditë, nga pasuria që e ka lënë i vdekuri nxirret sasia për të ushqyer një të varfër për çdo ditë. Nëse dikush vullnetarisht e bën pagimin e kësaj, kjo gjë është e lejuar.

44. Nëse agjëruesi fyhet apo shahet, ai nuk lejohet t'ia kthejë me sharje, por duhet të thotë: “Unë jam agjërueshëm apo unë jam duke agjëruar”. Nëse e kërkon nevoja, lejohet përsëritja e tij, pa marrë parasysh nëse agjërimiti është farz apo nafile.

45. Vonimi i syfyrit dhe shpejtimi i iftarit është sipas sunetit, nëse sigurohemi për perëndimin e diellit. Të gjitha këto janë shkaqe që umeti ynë të jetë në të mirë, ashtu siç ka ardhur në hadithe, prandaj mos nguroni në praktikimin e tyre.

46. Agjëruesi duhet të ketë kujdes të mos bëjë iftar para perëndimit të diellit.

47. Në çështjen e shpagimit (kefaretit) për prishjen e agjërimit me mardhënie seksuale duhet të ruhet radhitja ashtu si ka ardhur në hadithin e Ebu Hurejres, i cili gjendet te Buhariu dhe Muslimi. Kjo është edhe thënia e shumicës së dijetarëve.

48. Nëse agjëruesi ha apo pi nga harresa, obligohemi tia përkujtojmë atij, për shkak se agjërimiti është mirësi (punë e mirë) dhe ne jemi të obliguar ta ndihmojmë njëri-tjetrin në mirësi dhe devotshmëri.

49. Nëse burri zbavitet me gruan e tij (me puthje e përkëdhelje) gjatë agjërimit dhe i rrjedh nga organi medhiu (lëngu që rrjedh para spermës), sipas mendimit të saktë të dijetarëve, agjërimiti i tij është i saktë dhe nga ai nuk kërkohet asnjë lloj shpagimi, kjo për shkak se nuk ka argumente për të. Gjithashtu, nuk lejohet të bëjmë analogji (kijas) me rrjedhjen e spermës.

50. Dijetarët janë në mospajtim rreth çështjes së të agjëruarit nafile për atë person që ka borxh agjërimitin e ditëve të Ramazanit. Ata që kanë thënë lejohet e kanë përjashtuar nga lejimi i të agjëruarit e gjashtë ditëve të muajit Sheual, pa i plotësuar ditët e Ramazanit.